



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 482/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e dates 29.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfyqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-66404-07-23-2020, me objekt: *“Rehabilitimi i kanalit ujtes U3-27, V-1/1, në fshatin Bishqethem dhe Bitaj, NjA Kolonje”*, me fond limit 23 251 340 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 31.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Pasurise Publike Lushnje.

Shfyqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k
L.10 Korriku, Rr. “Perlat Rexhepi”, Objekt 3-katësh nr.4, Vlorë

Autoriteti Kontraktor:

Ndermarrja e Pasurise Publike
Lagjja “Gafurr Muco” Lushnjë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-66404-07-23-2020, me objekt: “*Rehabilitimi i kanalit ujites U3-27, V-1/1, ne fshatin Bishqethem dhe Bitaj, NjA Kolonje*”, me fond limit 23 251 340 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 31.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Pasurise Publike Lushnje.

II.2. Në datën 16.09.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k | 16.001.710 lekë, skualifikuar |
| 2. “Hastoçi” sh.p.k | 21.379.380 lekë, skualifikuar |
| 3. “Euro-Alb” sh.p.k | 22.645.350 lekë, kualifikuar |

BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k është njoftuar nga KVO për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë:

Ne piken 2, Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, te DST-se, si dhe ne baze te ligjit nr. 8378, date 22.07.1998, Kodi Rrugor i Rep. Shq. Bazuar ne nenin 82-90 jane konstatuar keto mangesi:

-Per mjetin tip Kamion me tr AA 376 DV, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 15.06.2017, me nr. Rep. 1422 ndermjet N. Leskaj , dhe Shoqerise “Avdyli ” shpk, me objekt marje

me qera mjeti, por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 90 , date 02.07.2020

- Per mjetin tip Kamion me tr.VL 1026 C, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 24.08.2018, me nr. Rep. 1156 te lidhur ndermjet G. Taraj, dhe Shoq. "Avdyli" shpk, me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 78 , date 05.06.2020

- Per mjetin tip Kamion me tr. AA 258 EV, marka Volvo eshte lidhur nje kontra te qeraje, me date 04.04.2018, me nr. Rep. 923 te lidhur ndermejt J. Gjonedaj dhe Shoq. Avdyl shpk me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 76 , date 03.06.2020

-Per mjetin tip Kamion me tr. PR 2132B, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 21.06.2020, me nr. Rep. 433 te lidhur ndermjet P. Shpata, dhe Shoq. Avdyl shpk me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 6 , date 18.03.2020

-Per mjetin tip Kamion me tr. AA 914 FV, marka Benc eshte lidhur nje kontraqte qeraje, me date 28.08.2020, me nr. Rep. 3228 te lidhur ndermejt P. Shpata, dhe Shoq. "Avdyli" shpk me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 57 , date 09.10.2019.

- Bazuar ne DST, Pika 2.3 Per kapacitetin teknik , pika a , pune e ngjashme, Kontrata per pune te ngjajshme "Rehabilitim i Ambjenteve Sportive te shkolles "Vasil Belshi, Shtermen dhe Aleks Buda" Cerrik e lidhur midis Bashkise Cerrik dhe shoqerise "Avdyli" , e lidhur me date 05.12.2018 nuk jane e paguar taksat vendore prane bashkise Cerrik, dhe nuk eshte pasqyruar ne QKB, ne Ekstaktin Historik

- Bazuar ne DST, Pika 2.3 Per kapacitetin teknik ,pika a, pune e ngjashme, Kontrata per pune te ngjashme "Mirembajtje e zakonshme objekteve te ndryshme", e lidhur midis Bashkise Permet dhe shoqerise "Avdyli" shpk, me date 10.08.2018 nuk jane paguar taksat vendore prane Bashkise Permet, dhe nuk eshte pasqyruar ne QKB, ne Ekstaktin Historik.

II.3 Në datën 19.09.2020, BOE "Avduli" sh.p.k & "Bahas" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë "Euro-Alb" sh.p.k. Konkretisht pretendohet si vijon:

"[...]"

Duke qene se skualifikimi jone eshte i padrejte dhe i pabazuar ne prova dhe ligj, si dhe i qellimshem nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, po ju paraqesim per shqyrtim ankesen prezente.

Referuar pikes 2 persa i perket tabelës se mjeteve, ne dokumentat standarte te tenderit eshte kerkuar:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit:
 - certifikaten e pronesise;
 - leja e qarkullimit;
 - certifikaten e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - taksat vjetore
 - leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese

ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Per te provuar disponimin e mjeteve qe shenohen ne regjistrat publik, Autoriteti Kontraktor ka kerkuar qe per cdo lloj mjeti te paraqiten dokumentat si me siper, dokumenta te cilat jane paraqitur nga ana jone dhe rezultojne te jene te gjitha te vlefshme.

Konkretisht me poshte po ju paraqesim sqarimet tona ne lidhje me kamionat e paraqitur ne kete procedure prokurimi.

Ne lidhje me kamionin me targe AA376DV, per te provuar disponimin e tij kemi paraqitur Kontraten e Qerase, Certifikaten e pronesise, Lejen e Qarkullimit, Certifikaten e Kontrollit Teknik, Taksen Vjetore, Siguracionin si dhe Certifikaten e Transportit e cila thote per transport mallrash per llogari te vet, por eshte dhene ne perdorim te subjektit juridik "Avduli" shpk dhe Certifikata e Transportit mban emrin e subjektit juridik "Avduli" shpk, nuk mban emrin e pronarit te mjetit. Kjo eshte nje certifikate qe leshohet nga Bashkia dhe perderisa Bashkia e ka leshuar certifikaten e Transportit ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk, atehere mjeti mund te perdoret per llogari te subjektit "Avduli" shpk. Ne rast se nuk do te lejohej qe ky mjet te jepej me qera atehere si mundet Bashkia ne shkelje te ligjit te leshoje certifikaten e transportit ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk ?? Pra ne momentin qe Certifikata e Transportit mban emrin e subjektit juridik "Avduli" shpk atehere transporti me kete mjet per llogari te shoqerise "Avduli" shpk nuk eshte i ndaluar.

Ne lidhje me mjetin tip kamion me targe VL1026C per te provuar disponimin e tij kemi paraqitur Kontraten e Qerase, Certifikaten e pronesise, Lejen e Qarkullimit, Certifikaten e Kontrollit Teknik, Taksen Vjetore, Siguracionin si dhe Certifikaten e Transportit e cila thote per transport mallrash per llogari te vet, por eshte dhene ne perdorim te subjektit juridik "Avduli" shpk dhe Certifikata e Transportit mban emrin e subjektit juridik "Avduli" shpk, nuk mban emrin e pronarit te mjetit. Kjo eshte nje certifikate qe leshohet nga Bashkia dhe perderisa Bashkia e ka leshuar certifikaten e Transportit ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk, atehere mjeti mund te perdoret per llogari te subjektit "Avduli" shpk.

Ne lidhje me mjetin tip kamion me targe AA258EV per te provuar disponimin e tij kemi paraqitur Kontraten e Qerase, Certifikaten e pronesise, Lejen e Qarkullimit, Certifikaten e Kontrollit Teknik, Taksen Vjetore, Siguracionin si dhe Certifikaten e Transportit e cila thote per transport mallrash per llogari te vet, por eshte dhene ne perdorim te subjektit juridik "Avduli" shpk dhe Certifikata e Transportit mban emrin e subjektit juridik "Avduli" shpk, nuk mban emrin e pronarit te mjetit. Kjo eshte nje certifikate qe leshohet nga Bashkia dhe perderisa

Bashkia e ka leshuar certifikaten e Transportit ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk, atehere mjeti mund te perdoret per llogari te subjektit "Avduli" shpk.

Pra per te tre kamionat e mesiper Certifikata e Transportit eshte leshuar ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk dhe duke gene se Certifikata e Transportit mban emrin e shoqerise "Avduli" shpk dhe eshte leshuar nga nje institucion publik, nuk mund te pretendohet nga ana juaj qe keto kamiona jane per perdorim vetjak dhe nuk mund te jepen me qera. Kamionat jane dhene me qera ne baze te nje Kontrate Noteriale e cila referuar Kodit Civil ka forcen e Ligjit per palet dhe pronari i mjetit ka te drejte ta jap mjetin e tij me qera. Neqoftese Certifikata e Transportit do te thoshte per perdorim vetjak dhe do mbante emrin e pronarit te mjetit atehere mund te pretendonit sa me siper por ne momentin qe Certifikata e Transportit eshte leshuar ne emer te subjektit juridik "Avduli" shpk (ne perdorim te subjektit juridik "Avduli" shpk) atehere shoqeria jone mund ta perdor kete mjet per transport. Gjithashtu sjellim ne vemendjen tuaj qe Institucioni qe ka leshuar kete Certificate ne rastin konkret Bashkia Vlore nuk e ka leshuar kot ne emer te subjektit "Avduli" shpk apo pa permbushur asnje kriter. Fakti qe kjo certificate eshte leshuar ne emer te shoqerise "Avduli" shpk do te thote qe jane plotesuar kushtet nga ana jone.

Ne lidhje me Kamionat me targe PR2132B dhe AA914FV kemi paraqitur te gjithe dokumentacionin qe eshte kerkuar nga ana juaj per kete procedure prokurimi dhe konkretisht, Kontraten e Qerase, Certifikaten e pronesise, Lejen e Qarkullimit, Certifikaten e Kontrollit Teknik, Taksen Vjetore, Siguracionin si dhe Certifikaten e Transportit. Per keto dy mjete Certifikatat e transportit jane ne emer te pronareve te dy mjeteve, pasi shoqeria jone ka lidhur kontratat e mesiperme pasi ka dale Certifikata e Transportit e per pasoje ne momentin qe ne keto mjete i kemi marre me qera nuk mund te nxjerrim perseri certifikaten e transportit ne emer te shoqerise "Avduli" shpk, pasi Certifikata ka gene e rinovuar per kete vit para se ne te nenshkruajme kontratat e qerase.

Konkretisht per mjetin me targe AA914FV Certifikata e Transportit me nr.57 date 09.10.2019 eshte leshuar me date 09.10.2019 dhe perfundon me date 09.10.2020 nderkohe qe Kontrata e qerase eshte nenshkruar me date 28.08.2020 dhe normale qe nuk mund te leshohet Certificate tjeter transporti ne emer te shoqerise "Avduli" shpk pa mbaruar afati i Certifikates ekzistuese.

Ne lidhje me mjetin me targe PR2132B Certifikata e Transportit me nr.6, 18.03.2020 eshte leshuar me date 18.03.2020 dhe perfundon me date 18.03.2021, nderkohe qe Kontrata e qerase eshte nenshkruar me date 21.06.2020. Pra dhe per kete kamion nuk mund te leshohet Certificate Transporti ne emer te subjektit "Avduli" shpk, pasi nuk ka mbaruar afati i Certifikates ekzistuese se Transportit.

Referuar Udhezimit Nr.15, date 24.7.2007"PER KRITERET DHE PROCEDURAT E LESHIMIT TE LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE NE TRANSPORTIN RRUGOR" Neni 11:

5.1.Raste te pajisjes ose jo me certificate te mjeteve te marra me qira.

a) Ne rastin kur nje mjet i marre me qira nuk ndryshon fushen e operimit (per te trete ose me qira ose per llogari te vet) per te cilen ai eshte pajisur me certificate, ai nuk pajiset me certificate te re, per pasoje, mjeti do te operoje me certifikaten e leshuar per subjektin transportues qe e ka dhene ate me qira. Ne te njejten menyre do te veprohet edhe per rastin kur

merret me qira nje mjet qe operon ne sherbimet e rastit te transportit nderkombetar rrugor te udhetareve dhe perdoret per te njejtin qellim.

Lidhur me pretendimin se per dy punet e ngjashme me objekt "Rehabilitim i ambienteve sportive te shkolles "Vasil Belshi" Shtermen dhe Vasil Buda Cerrik dhe "Mirembajtje e zakonshme te objekteve te ndryshme" e lidhur midis Bashkise Permet dhe shoqerise "Avduli" shpk me date 10.08.2018 nuk jane paguar taksat vendore prane Bashkise Cerrik dhe prane Bashkise Permet, sqarojme sa me poshte:

Ne kriteret per kualifikim eshte kerkuar qe Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen vitet 2018, 2019 dhe keset e maturuara te vitit 2020 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 " Per sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjitha vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe.

Se pari sqarojme Autoritetin Kontraktor se Bashkia Cerrik dhe Bashkia Permet nuk na kane gjeneruar detyrime e per pasoje nuk kemi se cfare vertetimi te paraqesim per keto dy Kontrata te Ngjashme. Referuar Ekstraktit Historik te shoqerise "Avduli" shpk ju bejme me dije se nuk kemi hapur asnje Nipt Sekondar per te cilin nuk kemi paraqitur Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore dhe perderisa ne Ekstraktin Historik te shoqerise tone nuk rezulton te kemi adrese te regjistruar per te cilen nuk kemi paraqitur vertetim, atehere Komisioni Vleresimit te Ofertave nuk mund te bazoje skualifikimin tone mbi pretendime dhe dokumentat qe subjekti jone nuk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi. Autoriteti Kontraktor nuk mund te detyroje operoret ekonomike te regjistrojne adresat e tyre ne QKB, pasi dicka e tille nuk eshte detyre e Autoritetit Kontraktor por perben tejkalim te kompetencave te tij.

Persa me siper Autoriteti Kontraktor duhet ti referohet Ekstraktit Historik te subjektit "Avduli" shpk persa i perket adresave sekondare te cilat subjekti jone ka te regjistruara dhe pastaj neqoftese do te kishte ndonje adrese sekondare te regjistruar ne QKB per te cilen nuk do te ishte paraqitur vertetim nga ana jone, atehere me te drejte Autoriteti Kontraktor mund te nxirrte arsye per skualifikim.

Lidhur me subjektin e vetem te kualifikuar nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave sjellim ne vemendjen tuaj faktin se ne shkelje te hapur me Ligjin per Prokurimin Publik, te Nenit 55 (Kriteret e Percaktimit te Ofertes Fituese), Komisioni Vleresimit te Ofertave nuk ka trajtuar ne menyre te barabarte ofertat e operatoreve ekonomik fakt i cili perben jo vetem shkelje administrative por i ngarkon dhe me pergjegjesi penale.

Subjekti i vetem i kualifikuar shoqeria EURO-ALB shpk ka shume mangesi ne dokumentacionin e paraqitur dhe duhet te ishte skualifikuar nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, por jo vetem qe nuk jane marre parasysh mangesite qe ka pasur ne dokumentacion por per te njejtat arsye qe ka nxjerre per skualifikim per shoqerine "Avduli" shpk, per shoqerine EURO-ALB shpk i ka kalur pa asnje problem (persa u perket Certifikates se Transportit per disa mjete). Pra, nuk ka perdorur barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen operatoreve ekonomik.

Konkretisht ne DST eshte kerkuar qe operatori ekonomik te kete ne stafin e punonjesve dhe te figurojne ne listpagesa per vitin e fundit punonjes te pajisur me deshmi te sigurimit teknik

nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente te akredituara sipas legjislacionit ne fuqi si dhe deshmi te kualifikimit profesional/ diploma/ certifikata trajnimi.

- Punonjesi E. Muca me profesion karpentier ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi D. Murati me profesion karpentier ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi D. Gjana me profesion karpentier ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi A. Veliko me profesion karpentier ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi A. Murati me profesion Hekurkthyes ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi Z. Nikolli me profesion Hekurkthyes ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi S. Gordoni me profesion Hekurkthyes ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Punonjesi N. Nikolla me profesion Hekurkthyes ka vetem certifikaten e sigurimit teknik por i mungon certifikata e kualifikimit.
- Asnje nga punonjesit me profesion Manovrator nuk ka deshmine e sigurimit teknik sipas dokumentave standarte te tenderit.
- Asnje nga punonjesit me profesion Shofer nuk ka deshmine e sigurimit teknik sipas dokumentave standarte te tenderit

Ne DST eshte kerkuar qe Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, me deshmi aftesie te leshuar nga subjektet e akredituar, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit staf si me poshte:

2 (dy) saldator, 1 (nje) nga keta duhet te jete i specializuar per punime ne prani te ujit.

Nga dokumentacioni qe eshte paraqitur ne kete procedure prokurimi rezulton se subjekti Euroalb ka paraqitur vetem nje saldator, punonjesin E. Hasa dhe nje punonjes per punimet ne prani te Ujit E. Mishtaku i cili ne kundershtrim me kriterin nuk eshte dhe saldator, pasi ne dokumentat standarte te tenderit jane kerkuar dy saldator ku njeri nga keta te jete dhe i specializuar per punime ne prani te ujit. Pra dhe ky kriter nuk eshte permbushur nga operatori ekonomik.

Ne DST eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te percaktoje me ane te nje deklarate te administratorit te shoqerise se Drejtuesit teknik te pakten, 1 Inxhinier Ndertimi, 1 Inxhinier Hidroteknik, 1 Inxhinier Mjedisi, do te jene te pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt dhe jane te paangazhuar ne kontrata te tjera, te pajisur me diplome dhe kontrate noteriale pune, dhe te figuroje ne listepagesa per periudhen janar 2020- deri sa te mbaroje vepra.

Nga dokumentacioni qe subjekti Euroalb ka paraqitur ne kete procedure prokurimi rezulton se Ing.Mjedisi A. Hoxhaj qe subjekti Euroalb ka deklaruar se se do te jete njera nga drejtueset teknike ne objekt dhe e cila nuk eshte e angazhuar ne kontrata te tjera, rezulton se

kjo Ing.Mjedisi (A. Hoxhaj) eshte dhe drejtuese teknike te Kontrata si me poshte sipas deklarates qe subjekti Euroalb ka paraqitur ne kete procedure prokurimi:

*J.V EURO-ALB SHPK BASHKIA SHIJAK REHABILITIMI I 51,789,576 PA TVSH
95 % VIANTE KANALIT UJITES
Konstruksion 5% HARDHISHTE*

Drejtues Teknik:

A. Hoxhaj

Ne DST jane kerkuar nder te tjera dhe 3 Kamioncina vetshkarkuese min 2,5-5 ton. Ne kete procedure me kete kapacitet jane paraqitur 2 kamioncina, ne shtojcen e mjeteve jane deklaruar 3 kamioncina me targe AA907MF, AB364AF dhe TR3893F por, kamioncina me targe TR3893F i ka skaduar Polica e Sigurimit (siguracioni), keshtu qe ne kete rast kriteri per tre kamioncina me kapacitet 2,5 deri ne 5 ton nuk eshte plotesuar.

Ne DST jane kerkuar nder te tjera dhe dy Fadroma me Goma.

Fadroma me targe ACMT62 eshte e sakte ndersa Fadroma me targe TR6157J nuk ka Leje Qarkullimi dhe nuk ka dokumentat e tjera qe duhet te kete nje mjet me goma. Pra nuk mund te merret si e sakte perderisa i mungojne dokumentat qe duhet te kete nje mjet me goma. Gjithashtu ne DST jane kerkuar dhe dy eskavator me Goma, nga keta dy eskavator vetem eskavatori me targe AEMT38 eshte i rregullt pasi ka te gjitha dokumentacionin qe kerkohet per mjetet me goma, ndersa Eskavatori me Fature nr.42, 17.01.2017 nuk mund te merret ne konsiderate pasi eshte eskavator me Goma dhe duhet te kishte Leje Qarkullimi si dhe dokumentat e tjera qe ka nje mjet me goma. Pra edhe ne kete rast kriteri nuk eshte permbushur pasi vetem nje Eskavator me Goma eshte i rregullt, ndersa tjetri nuk eshte i sakte.

Gjithashtu absurditeti i Komisionit te Vleresimit te ofertave arrin kulmin kur skualifikon shoqerine "Avduli" shpk per Certifikatat e Transportit te kamionave me pretendimin se certifikata e transportit eshte per llogari te vet nderkohe qe shoqerine EURO-ALB shpk nuk e skualifikon per kamionin me targe AA364 AF E CILA ESHTË CERTIFIKATE PER TRANSPORT MALLRASH PER LLOGARI TE VET LESHUAR NE EMER TE SHOQERISE LOTI SHPK. (A PERBEN SHKELJE ADMINISTRATIVE DHE PENALE NJE FAKT I TILLE?? A DUHEN PERDORUR DHE TRAJTUAR NE MENYRE TE BARABARTE OFERTUESITE DHE DOKUMENTAT OE PARAOITEN NE NJE PROCEDURE PROKURIMI?? PATJETER OE PO).

Kamioni me targe AA907MF me Certificate Transporti (transport mallrash per llogari te vet), leshuar ne emer te subjektit "Loti" shpk.

Kamioni me targe AA529PP me Certificate Transporti (transport mallrash per llogari te vet), leshuar ne emer te subjektit "Loti" shpk.

Kamioni me targe AA175GC me Certificate Transporti (transport mallrash per llogari te vet), leshuar ne emer te subjektit "Loti" shpk. [...]."

II.4. NËPËRMJET SHKRESËS NR. 327 PROT., DATË 25.09.2020 AUTORITETI KONTRAKTOR I KA KTHYER PËRGJIGJE ANKIMUESIT SI VIJON:

"[...]."

Subjekti pretendon se: Per mjetin tip kamion me targe AA376DV, MARKA Benz eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 15.06.2017, me nr.Rep.1422 ndermjet N. Leskaj dhe shoqerise "Avduli" shpk, me objekt marrje me qera mjeti, por nga dokumentacioni i

paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund te jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe me certifikaten nr.90, date 02.07.2020. Per mjetin tip kamion me targe VL1026C, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje me date 24.08.2018, me nr.Rep 1156 te lidhur ndermjet G. Taraj dhe shoqerise "Avduli" shpk me objekt marrje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe me certifikaten nr.78, date 05.06.2020. Per mjetin tip kamion me targe AA258EV eshte lidhur nje kontrate qeraje me date 04.04.2018 me nr.Rep 923 te lidhur ndermjet J. Gjonedaj dhe shoqerise "Avduli" shpk me objekt marrje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorirn vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe me certifikaten nr. 76, date 03.06.2020. Per mjetin tip kamion me targe PR2132B eshte lidhur nje kontrate qeraje me date 21.06.2020, me nr.Re.433 te lidhur ndermjet P. Spata dhe shoqerise "Avduli" shpk me objekt marrje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorirn vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe me certifikaten nr.6, date 18.03.2020. Per mjetin tip kamion me targe AA914FV eshte lidhur nje kontrate qeraje me date 28.08.2020 me nr.Rep.3228 me objekt marrje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe me certifikaten nr.57, date 09.10.2019. Ne lidhje me dokumentacionin e mjeteve pergjigja eshte e njejte. Ajo eshte e bazuar ne ligjin nr. 83 78, date 22.07.1998. Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise specifikisht neni 82-90 ku mjetet e peracaktuara per perdorim vetjak nuk mund te jepen me qera per persona te trete. Persa i perket pretendimit ne lidhje me taksat. [...]

Autoriteti kontraktor nuk detyron operatoret te shlyejne taksat por ka te drejte ta vendosi si kriter ne DST ne momentin qe ai eshte nje kriter i ligjshem.

Bazuar ne legjislacionin Tatimor 2016 Ligji nr 9920 date 19.05.2008, Ne kreun V neni 40 Personat e regjistruar ne administraten tatimore pajisen c numer identifikimi unik (NUIS), te gjeneruar nga sistemi, i cili sherben si numer identifikimi tarimor te tyre, per tatimet kombetare dhe vendore. Menyra e regjistrimit te ketyre personave prane administrates tatimore percaktohen me udhezim te Ministrit te Financave. Pika 5 parashikon se "Mosregjistrimi nuk e cliron nje person nga pagesa e detyrimit tatimor ose permbushja e detyrimeve te tjera tatimore".

Pavaresisht justifikimeve nga ana juaj ne lidhje me arsyet e skualifikimit dhe pretendimet ne lidhje me informacionin qe zoteroni per operatorin tjeter (edhe pse nuk eshte aspak ligjore) ju informojme se:

Ne lidhje me operatorin Euro Alb eshte kualifikuar ne lidhje me mjetet, pasi ai ka ofruar me shume mjete dhe si e tille mjetet me dokumentacion te rregullt perbejne numrin e mjeteve te percaktuara ne DST.

Edhe sa i perket specialistit i cili duhet te jete saldator dhe te punoje ne prani te ujit operatori ekonomik Euro Alb e zoteron me deshmite perkatese sipas ligjit. [...]."

II.5. Në datën 05.10.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në AK.

II.6. Në datën 16.10.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 1222/3 prot, shkresa e autoritetit kontraktor nr 345 prot., datë 14.10.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k SE: “Per mjetin tip Kamion me targe PR 2132B, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 21.06.2020, me nr. Rep. 433 te lidhur ndermjet P. Shpata, dhe Shoq. Avdyl shpk me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 6 , date 18.03.2020. -Per mjetin tip Kamion me tr. AA 914 FV, marka Benc eshte lidhur nje kontrate qeraje, me date 28.08.2020, me nr. Rep. 3228 te lidhur ndermjet P. Shpata, dhe Shoq “Avduli” shpk me objekt marje me qera mjeti por nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se ky mjet eshte per perdorim vetjak dhe si i tille nuk mund ti jepet nje pale te trete, per post ligjit kjo eshte e dokumentuar edhe ne certifikaten nr. 57, date 09.10.2019”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së nësipërme të prokurimit, lidhur me mjetet, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t;i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
	Kamiona vetshkarkues mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
	Kamioncina vetshkarkues min 2.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
	Autovinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Betoniere kantieri 1.5-3 m3	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Pompa uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Fadroma me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Ekskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m	në pronësi ose me qira	Copë 1
	Saldatrice, motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 2
	Fabrike betoni pajisur me leje mjedisore	në pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

[...]

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:*
 - *çertifikatën e pronësisë;*
 - *leja e qarkullimit;*
 - *çertifikatën e kontrollit teknik;*
 - *siguracionin;*
 - *taksat vjetore*
 - *leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot përkatëse;**ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
- *Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.*
- *Deklaratë nga administratori i shoqërisë që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesi pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara më sipër, në rast se do të lindë nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese.*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.*

III.1.3. Në nenin 26 pika 8 “Kontrata për punë publikë” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet si më poshtë: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në*

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...”.

III.1.4. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi lidhur ndërmjet shoqërisë “Avduli” sh.p.k dhe shoqërisë “Bahas” sh.p.k, nga ku shoqëria “Avduli” sh.p.k merr përsipër realizimin e objektit të mësipërm të prokurimit në masën 70.03 % dhe shoqëria “Bahas” sh.p.k merr përsipër realizimin e kontratës në masën 29.97 %.

Gjithashtu, është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Avduli” sh.p.k është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton se, në përmbushje të kriterit për mjetet “kamioncine”, shoqëria “Avduli” sh.p.k ka paraqitur:

- Deklaratë “Mbi Disponimin e Makinerive” ku, ndër të tjera, janë deklaruar me qira mjetet “kamioncine” me targa PR2132B dhe AA914FV.
- Kontratë qeraje Nr. 433 Rep dhe Nr.192 Kol datë 21.06.2020, të lidhur, ndërmjet personit fizik P.Shpata, në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Avduli” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, për dhënien me qera të mjetit me targë PR 2132B, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, për një periudhë 3 vjecare. Për mjetin me targë PR 2132B është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:
 - Çertifikate e kontrollit teknik
 - Siguracioni i mjetit
 - Leje qarkullimi e mjetit në emër të P.Shpata.
 - Certifikatë pronësie e mjetit
 - Taksa vjetore
 - Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet (në përdorim të personit juridik P.Shpata).

- Foto të mjetit me targë PR 2132B
- certifikatë regjistrimi “Avduli” sh.p.k.,-
- Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjesi të kufizuar (Avduli sh.p.k. datë 20.06.2020)
- Kontratë qeraje Nr. 1160 Rep dhe Nr.325 Kol datë 28.08.2020, të lidhur, ndërmjet shoqërisë Sisteme Ndertimi Kokoneshi Beton, në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Avduli” sh.p.k., në cilësinë e qeramarrësit, për dhënien me qera të mjetit me targë AA 914FV, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, për një periudhë 3 vjecare. Për mjetin me targë AA 914FV është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:
 - Certifikatë pronësie e mjetit
 - Leje qarkullimi e mjetit në emër të Sisteme Ndertimi Kokoneshi Beton
 - Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet (në përdorim të shoqërisë Sisteme Ndertimi Kokoneshi Beton).
 - Siguracioni i mjetit
 - Taksa vjetore
 - Çertifikate e kontrollit teknik
 - Foto të mjetit me targë AA 914FV
 - Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjesi të kufizuar Avduli sh.p.k., datë 27.08.2020.

III.1.7. Në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] 1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike. 2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik. 3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët. 4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit. 5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve. 7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet. 8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se lex specialis, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikata e mjetit me targë PR 2132B të cilin e disponon P. Shpata., është dhënë në përdorim të vet personit juridik P. Shpata, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “Avduli” sh.p.k të mallrave me kamionin e sipërcituar të P. Shpata do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. K.P.P gjykon se certifikata e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatorët ekonomikë. Mungesa e certifikatës së mësipërme, vërteton vetëm faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Gjithashtu për mjetin me targë AA 914FV, përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit të cilën e disponon shoqëria Sisteme Ndertimi Kokoneshi Beton sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt si dhe certifikata për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, brenda vendit, është vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.

Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “Avduli” sh.p.k të mallrave me kamionin e shoqërisë “Sisteme Ndertimi Kokoneshi Beton” sh.p.k., do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

K.P.P gjykon se licenca e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatorët ekonomikë.

Mungesa e licencës së mësipërme, vërteton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

III.1.9. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit,

pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Avduli" sh.p.k, anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Avduli" sh.p.k & "Bahas" sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për mjetet "kamioncinë" dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa*

identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ankimuesit përsa i përket skualifikimit të tij të padrejtë nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit të dhënë në pikën III.1 të arsyetimit, vlerëson se këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimet e palës ankimuese për skualifikimin e operatorit ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se;

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Avduli” sh.p.k & “Bahas” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-66404-07-23-2020, me objekt: *“Rehabilitimi i kanalit ujites U3-27, V-1/1, ne fshatin Bishqethem dhe Bitaj, NjA Kolonje”*, me fond limit 23 251 340 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 31.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Pasurise Publike Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1222 Protokolli,

Datë 09.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri